



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BASHKIA E QYTETIT KORÇE**  
**NDERMARRJA E SHERBIMEVE PUBLIKE**

ADRESA : URA E FAJANCES

TEL

++ 355 824 3150

## RELACION

### **“Për miratimin e ndjekjes së procedurave ligjore të ankandit publik për shitjen për skrap të aktiveve të nxjera jashtë përdorimit nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë”**

Gjatë vitit 2016 dhe vitit 2017 nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë janë ndjekur procedurat ligjore për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të inventarit të cilat e kanë plotësuar kohën e shfrytëzimit, nuk mund të riparohen apo të përshtaten për përdorim tjetër.

Vlera e riparimit të këtyre materialeve për t'i kthyer në gjendje pune është më e lartë se vlera e vetë materialeve në inventar dhe më e lartë se vlera e tregut për blerjen e materialeve të tjera, kjo si pasojë e konsumit të madh të tyre. Materialet kane humbur cilësitë e tyre fizike dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar ose për një qëllim tjetër në formën që janë ose në një formë tjetër.

Rrjedhimisht, duke qënë se këto materiale nuk janë të nevojshme për veprimtarinë e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë dhe nuk është e mundur të përdoren në njësi të tjera, komisionet përkatëse të ngritura me urdhër të Titullari të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike kanë propozuar, duke patur parasysh përbërjen e materialeve prej hekuri, shitjen e tyre për skrap duke ndjekur procedurat ligjore të ankandit publik.

Për efektet ekonomike dhe financiare të nxjerrjes së materialeve jashtë përdorimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, është njoftuar Këshilli i Bashkisë Korçë.

Për këtë arsye mbështetur në:

Ligjin nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, nenin 54/e të tij, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, udhëzimin plotësues nr. 8 datë 13.01.2017 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017”, udhëzimin nr. 2 datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Vendimin e Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 5 datë 12.01.2017 “Mbi miratimin e Buxhetit të Bashkisë, njësisive administrative, institucioneve të vartësisë dhe funksioneve të reja për vitin 2017”, të ndryshuar, ligjin nr. 10296 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, të ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” dhe ndryshimet e tij, ligjin nr.9874, datë 14.2.2008 “Për



ankandin publik”, të ndryshuar, vkm nr.1719, datë 17.12.2008“Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, të ndryshuar, kërkojmë:

- Miratimin e ndjekjes së procedurave ligjore të ankandit publik për shitjen për skrap të aktiveve të nxjera jashtë përdorimit nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë sipas llogarive ekonomike më poshtë :

1. Llogaria ekonomike 214 në vlerën .....**5,355,300 lekë**
2. Llogaria ekonomike 214 në vlerën .....**1,299,975 lekë**
3. Llogaria ekonomike 215 në vlerën .....**20,626,068 lekë**
4. Llogaria ekonomike 214.1 në vlerën .....**3,830,574 lekë**
5. Llogaria ekonomike 32.1 në vlerën .....**1,642,069 lekë**

**Sqarim:** Vlerat e llogarive ekonomike më sipër janë vlerat e inventarit fillestar të aktiveve. Vlera e aktiveve të nxjera jashtë përdorimit nga komisionet e posaçme të ngritura me urdhër të veçantë të Titullarit të ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, do të përcaktohet nga një ekspert i fushës i cili do të zgjidhet nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike në përputhje me ligjin nr. 9643 të datës 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

**DREJTORI**

Thanas TONA



**Drejtoria Juridike**

Anxhela Dishnica

**KRYETARI**

Sotiraq Filo